

**Vendim nr.108 datë 20.05.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Gj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **GJERGJ ÇUPI**, përfaqësuar nga avokatët Gjovalin Përnoca dhe Fran Rica, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 9, datë 23.02.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë; nr. 578, datë 23.10.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-1920 (287), datë 31.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, me vendimin nr. 9, datë 23.02.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë është deklaruar fajtor për veprat penale “Vrasja me paramendim”, “Vrasja me paramendim”, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake” të parashikuara nga nenet 78, 78-22 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP) dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 25 vjet burgim. Vendimi i dënimit nuk është ankimuar brenda afatit ligjor nga asnjë prej palëve.

2. Gjatë hetimit paraprak, ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit e arrestit në burg, e cila nuk është ekzekutuar, ndaj gjykata e shkallës së parë ka deklaruar ikjen e tij dhe i ka caktuar mbrojtës kryesisht. Për rrjedhojë, vendimi penal i dënimit është dhënë në mungesë të tij.

3. Pas 18 vjetëve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 89, datë 01.06.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit të kërkuesit. Mbi bazën e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur i kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 578, datë 23.10.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të dënimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë të parashikuara nga nenet 76 dhe 76-22 të KP-së dhe në bashkim të dënimeve, e ka dënuar sërish me 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs, përmes mbrojtësit të zgjedhur.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1920 (287), datë 31.10.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

5. Në datën 29.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.03.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi nuk janë respektuar aspektet e mëposhtme:

- 6.1. *E drejta e mbrojtjes*, pasi në gjykimin në shkallë të parë, të zhvilluar në mungesë të kërkuesit, atij i është caktuar avokat kryesisht, i cili nuk e ka përmbushur detyrën. Avokati kryesisht ishte caktuar gjatë hetimit paraprak dhe nuk kishte tagra për mbrojtjen e kërkuesit edhe në gjykim. Ai ka luajtur rol pasiv, si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes, si dhe ka pranuar fajësinë e kërkuesit, duke kërkuar mëshirë në emër të tij, pa e pasur këtë atribut sipas ligjit.
- 6.2. *Parimi i kontradiktoritetit*, pasi dënimi i tij është mbështetur vetëm te dëshmitarët e akuzës së paraqitur në gjykimin në shkallë të parë, të zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Dëshmitarët nuk kanë qenë personalisht në vendngjarje dhe deklaratimet e tyre janë të pakonfirmuara. Provat shkresore nuk faktojnë se kush ka qenë autor i veprës penale. Gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e tij për marrjen e provave, thirrjen, pyetjen dhe vlerësimin e dëshmitarëve, ose përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor.
- 6.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi, *së pari*, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë analizë të hollësishme të provave në raport me faktet e çështjes, por ka dalë *apriori* në përfundimin për fajësinë së kërkuesit. Ajo ka çmuar në mënyrë të gabuar provat, pasi të gjitha deklaratimet janë të prejardhura dhe të pakonfirmuara nga burimi i tyre. *Së dyti*, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është nënshkruar nga të gjithë gjyqtarët. Kjo shkelje, e cila shkakton pavlefshmërinë absolute të vendimit, nuk është konstatuar dhe korrigjuar as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual në çdo rast duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të

ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, çmon se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*. Ai ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, kërkuksi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, me argumentin se vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte nënshkruar nga të gjithë gjyqtarët e trupit gjykues dhe se kjo shkelje përbën pavlefshmëri absolute të vendimit, që nuk është konstatuar as nga Gjykata e Apelit Shkodër, as nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkuksit, ai është vënë në dijeni të kësaj shkeljeje në datën 19.02.2024, nga mbrojtësi i zgjedhur për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

11. Kolegji, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës, garancitë e të cilit janë detajuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), vëren se gjatë procesit penal individi ka të drejtë të mbrohet me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur vetë. Në këtë kuptim, mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore (neni 6 i *KPP*-së), ka tagrat e duhura ligjore për t’u njohur me aktet dhe për të paraqitur në emër dhe për llogari të të pandehurit çdo kërkesë që ai e çmon të nevojshme (nenet 48 e vijues të *KPP*-së).

12. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuksi i ka pasur të gjitha mundësitë që pretendimin për nënshkrimin e vendimit penal të dënimit ta parashtronte në aktet e apelit dhe të rekursit, akte të cilat janë përpiluar dhe paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur prej vetë atij.

Zgjedhja e një mbrojtësi tjetër për të paraqitur ankimin kushtetues individual nuk e shkarkon kërkuesin nga përgjegjësia për të përmbushur detyrimin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi për këtë pretendim nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi i ka ngritur ato në formë dhe në substancë në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, për rrjedhojë ai ka shteruar mjetet juridike efektive.

14. Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 31.10.2023, ndërsa ankimi është paraqitur në Gjykatë në datën 29.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së mbrojtjes, parimit të kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Lidhur me këtë të fundit, ai ka parashtuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë analizë të hollësishme të provave në raport me faktet e çështjes, por ka dalë *apriori* në përfundimin për fajësinë e kërkuesit. Sipas tij, gjykata ka çmuar në mënyrë të gabuar provat, pasi të gjitha dëshmitë janë të prejardhura dhe të pakonfirmuara nga burimi i tyre. Kolegji thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është i papranueshëm *ratione materiae*. Ndërsa, pretendimet për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit, të cilat garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, si aspekte të procesit të rregullt ligjor, *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, ndaj Kolegji do t'i analizojë në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes*

16. Kërkuesi ka pretenduar se nuk ka pasur mbrojtjen e duhur gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar, në mungesë të tij, në gjykatën e shkallës së parë. Avokati i caktuar kryesisht nga gjykata nuk e ka përmbushur detyrën në përputhje me ligjin dhe me detyrimet e tij ndaj klientit. Avokati është caktuar në fazën e hetimeve paraprake dhe nuk kishte tagra për përfaqësimin e kërkuesit në gjykim, pasi është caktuar mbrojtës nga gjykata pas deklarimit të

mungesës së tij. Edhe pse nuk kishte tagra, mbrojtësi është paraqitur në seancën gjyqësore të datës 11.11.1998 dhe ka rënë dakord me përbërjen e trupit gjykues, si dhe me deklarin e mungesës dhe gjykimin e kërkuesit në mungesë. Mbrojtësi i caktuar kryesisht ka luajtur rol pasiv, si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes. Në fund të gjykimit, ai është shprehur se kërkonte dënim më të butë për kërkuesin, ka kërkuar mëshirë në emër të tij, për sa i përket dënimit, duke tejkalluar tagrat e tij të përfaqësimit, pasi ka pranuar fajësinë e kërkuesit pa e pasur këtë atribut, ndonëse sipas nenit 50 të KPP-së kjo e drejtë i rezervohet personalisht kërkuesit.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në veçanti për procesin penal, shkronja “ç” e nenit 31 të Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtje falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

18. Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Realizimi substancial i mbrojtjes së individit është, në radhë të parë, përgjegjësi e mbrojtësit, që pranon detyrën e caktuar, duke vijuar më tej me përgjegjësinë që ka Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, e cila, në kuadër të vetërregullimit, ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të kujdeset për veprimtarinë profesionale që ushtron mbrojtësi, duke e përmbyllur me rolin që duhet të luajnë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, të cilat duhet të sigurojnë realisht të drejtën kushtetuese të mbrojtjes së individit. Për më tepër, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, konstatojnë se kur përgjegjësitë e lidhura me mbrojtjen qartazi nuk përmbushen, ato kanë përgjegjësinë që ta raportojnë rastin për verifikim dhe kontroll pranë organit kompetent (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se në kuptim të nenit 6 § 3, (c) të KEDNJ-së, që parashikon të drejtën për ndihmë ligjore “praktike dhe efektive”, thjesht “caktimi” i një avokati nuk siguron ndihmë efektive dhe se autoritetet kanë detyrimin të sigurohen që ai të përmbushë detyrat e tij (*shih Falcao dos Santos k. Portugalisë, 3 korrik 2012,*

§ 42). Për shkak të pavarësisë së profesionit të avokatit, sjellja e mbrojtësit është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij. Shteteve kontraktuese u kërkohet të ndërhyjnë vetëm nëse dështimi nga avokati për të ofruar përfaqësim efektiv është i dukshëm ose u vihet mjaftueshëm në vëmendje në ndonjë mënyrë tjetër (*shih Daud k. Portugalisë, 21 prill 1998, § 38*). Përgjegjësia e shtetit mund të lindë kur një avokat thjesht nuk vepron në favor të të akuzuarit (*shih Artico kundër Italisë, 13 maj 1980, §§ 33 dhe 36*) ose kur ai nuk përmbush një kërkesë thelbësore procedurale që nuk mund të barazohet thjesht me një linjë të padrejtë mbrojtjeje ose një defekt të thjeshtë argumentimi (*shih Czekalla kundër Portugalisë, 10 tetor 2002, §§ 65, 71*).

20. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkuesi është deklaruar i ikur për shkak se i është shmangur masës së sigurimit të arrestit në burg. Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të tij, por me pjesëmarrjen e një mbrojtësi të caktuar kryesisht. Në këtë pikëpamje, nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të ketë penguar kërkuesin të ushtrojë mbrojtje efektive, përkundrazi, ka përmbushur detyrimet ligjore duke i caktuar atij mbrojtës kryesisht, në kushtet kur kërkuesi ka zgjedhur t'i fshihet drejtësisë. Nga ana tjetër, ashtu siç ka arsyetuar Gjykata e Lartë, ligji procedural penal nuk pengon që i njëjti mbrojtës të përfaqësojë individin gjatë hetimit paraprak dhe gjykimin të çështjes, ndaj ky argument i kërkuesit nuk qëndron. Për sa i takon argumentit për rolin pasiv të mbrojtësit, Kolegji vëren se nuk rezultojnë të dhëna që mbrojtësi i caktuar të ketë vepruar në kundërshtim me interesat e kërkuesit ose të mos ketë përmbushur kërkesa thelbësore procedurale. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se linja e mbrojtjes së avokatit të caktuar kryesisht, pavarësisht pretendimeve të kërkuesit në lidhje me saktësinë e saj, nuk përbën argument të mjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka përmbushur përgjegjësitë e saj kushtetuese për të garantuar të drejtën substanciale të mbrojtjes së kërkuesit në procesin penal. Po kështu, Kolegji vëren se edhe pse mbrojtësi i caktuar kryesisht ka kërkuar mëshirë, ky qëndrim nuk rezulton të ketë përcaktuar fajësinë e kërkuesit, pasi gjykata e shkallës së parë fajësinë e kërkuesit e ka arsyetuar bazuar në përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe jo në deklaratimet e mbrojtësit. Gjithashtu, Kolegji evidenton se kërkuesi është mbrojtur me avokat të zgjedhur prej tij në shkallët e tjera të gjykimin, duke pasur në këtë mënyrë mundësinë e strategjisë së duhur të mbrojtjes.

21. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në aspektin substancial është haptazi i pabazuar.

*C. Për pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit*

22. Kërkuesi ka pretenduar se hetimi gjyqësor i zhvilluar nga gjykatat e faktit është i paplotë dhe me shkelje të rënda procedurale, pasi vendimet gjyqësore mbështeten vetëm te dëshmitarët e akuzës së paraqitur në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, në mungesë të kërkuesit. Dëshmitë e marra janë lëshuar nga persona që nuk kanë qenë personalisht në vendngjarje, pra deklaratimet e tyre janë të prejardhura dhe të pakonfirmuara nga burimi i tyre. Provat shkresore nuk faktojnë se kush ka qenë autor i veprës penale. Edhe pse është vlerësuar se vepra penale është kryer për gjakmarrje, nuk ka asnjë deklaratim se kush e ka kryer atë. Gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e tij për marrjen e provave, thirrjen, pyetjen dhe vlerësimin e dëshmitarëve, ose përsëritjen e pjeshme të shqyrtimit gjyqësor.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaratimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar vijimësisht se vlerësimi i fakteve dhe provave nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjatë gjykimit në shkallë të parë, mbrojtësi i kërkuesit nuk ka paraqitur kërkesa për prova, ndaj shqyrtimi gjyqësor është zhvilluar duke administruar provat shkresore dhe dëshmitarët e kërkuar nga prokurori. Provat e prokurorit i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe mbrojtësit të kërkuesit i është dhënë mundësia nga gjykata për t'i kundërshtuar ato. Ankimi i kërkuesit është rivendosur në afat nga gjykata dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij ka pasur mundësinë e parashtrimit të argumenteve ligjore dhe faktike në aktet e ankimit drejtuar gjykatave më të larta. Në aktin e apelit, mbrojtësi i kërkuesit nuk ka kërkuar marrjen e ndonjë prove të re, por është mjaftuar me kërkesën procedurale për riçeljen e hetimit gjyqësor në shkallë të dytë, duke paraqitur si shkak rimarrjen në pyetje edhe njëherë të dëshmitarëve të prokurorit që ishin pyetur në shkallë të parë. Gjykata e apelit nuk e ka pranuar kërkesën, duke arsyetuar se provat e marra nuk ishin të dyshimta, të pakonfirmuara ose kontradiktore, përkundrazi, përputheshin me njëra-tjetrën. Sipas saj, në gjykimin në shkallë të parë, provat ishin marrë dhe fiksuar në aktet procedurale në respektim të plotë të ligjit



procedural penal. Në vijim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ligji nuk detyron gjykatën për të riçelur shqyrtimin gjyqësor vetëm për shkak të zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë në mungesë të të pandehurit. Sipas saj, fajësia e kërkuesit bazohet në disa prova, dëshmi të personave të cilët kishin qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me të gjykuarin, si dhe të personave të tjerë që kishin marrë të dhëna prej personave të parë.

25. Nga analiza e këtyre rrethanave, Kolegji çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë krijuar kërkuesit mundësi të barabarta me prokurorin për të marrë pjesë në çdo shkallë të gjykimit. Në gjykimin në shkallë të parë, gjykata i ka caktuar mbrojtës kryesisht kërkuesit, si dhe ka rivendosur në afat apelin e tij. Aktet e apelit dhe të rekursit janë paraqitur përmes mbrojtësit të zgjedhur, i cili ka marrë pjesë rregullisht në gjykimin e çështjes në shkallët e tjera. Mbrojtësit të caktuar dhe mbrojtësit të zgjedhur u është dhënë mundësia të deklarohen për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen e fajësisë së kërkuesit. Ndërkohë, nuk rezulton që mbrojtësi, përfshirë atë të zgjedhur nga vetë kërkuesi, të ketë paraqitur ndonjë kërkesë për marrjen e provave të ndryshme nga ato të paraqitura nga prokurori. Ashtu siç kanë vënë në dukje gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, kërkesa për ripyetjen edhe njëherë e dëshmitarëve të prokurorit në shkallë të dytë ishte e pabazuar në kushtet kur mbrojtësi nuk ka paraqitur ndonjë argument ligjor se përse ishte e nevojshme ripyetja, aq më tepër kur kjo ripyetje kërkohej të zhvillohej pas 18 vjetëve, që në mënyrë të arsyeshme përbën një kohë të gjatë me ndikim në kujtesën e dëshmitarëve. Për sa i përket argumentit të kërkuesit për përmbajtjen e provave dhe vlerën provuese të tyre për fajësinë e tij, Kolegji çmon se ai lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave, që është në kompetencë të gjykatave të zakonshme, ndaj nuk mund të merret parasysh.

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.